



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.10, datë 17.04.2019**

**Për**

**“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>1. Z. Ilir</b>	<b>Zela</b>	<b>Kryetar</b>
<b>2. Znj. Edlira</b>	<b>Dvorani</b>	<b>Anëtare</b>
<b>3 Znj. Ketrin</b>	<b>Topçiu</b>	<b>Anëtare</b>
<b>4. Znj. Xhoana</b>	<b>Lilaj</b>	<b>Anëtare</b>

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 17.04.2019 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: "Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI (Rregullimi i Konkurrencës) të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;

3. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: *“Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”*;
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akit miratues të dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N :**

1. Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare në rrjetet celulare së bashku me analizën për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është përgatitur në zbatim të Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe merr në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, me synimin përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë. Ky document:
  - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
  - b. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
  - c. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkates, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
  - d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
  - e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.
2. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme, është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, gjithashtu edhe pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014, dhe për këtë arsye AKEP nuk e konsideron

të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse ky treg është treg përkatës i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante..

3. Bazuar në rregulloren Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme si tregje të mundshme për ndërhyrje ex-ante në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, inter allias:
  - a. Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të levizshme.
4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2007 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve.
5. Në tregun përkatës të terminimit secili operator i rrjetit të shërbimeve celulare është me fuqi të ndjeshme në treg pasi është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, përfshirë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare.
6. Pas konsultimit publik të dokumentit AKEP vijon me marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuara për terminimin e thirrjeve, dhe masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me status me FNT si dhe rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 60 ditore nga data e publikimit të dokumentit.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”, të publikohen në faqen e internetit [akep.al](http://akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**KRYETAR**

**Ilir Zela**

**ANËTAR**

**Edlira Dvorani**

**ANËTAR**

**Ketrin Topçiu**

**ANËTAR**

**Xhoana Lilaj**